

REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -XI-TË ME RADHË E -VI- E RREGULLT E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 24 SHTATOR 2020

Mbledhja është mbajtur në objektin e Qendrës Rinore në Vushtrri, duke filluar në orën 10:38.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rustemi, Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z. Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, adresoi shqetësimin se qeveria komunale ka filluar prapë me diskriminimin e të punësuarve në komunë në baza partiake. Fazli Muharremi - Tali po persekutohet në vazhdimësi nga kjo qeveri komunale pa arsye po vetëm pse është anëtar i PDK-së i njëjti është tentuar të goditet nga kjo qeveri disa herë dhe këto goditje të ulëta po bahen me qellim që ta ndalin fjalën e lirë sepse Fazliu Muharrem është gazetar ka shkruar vazhdimisht për dukuri negative dhe shkrimet janë pretekst për shantazh nga kjo qeveri. Ju rikujtoj se artisti Fazli Muharremi ka shkruar nga 2005 dhe vazhdon të shkruaj e të kritikoj për dukuri negative dhe këtë e çmojmë dhe duhet të çmohet e jo të ndëshkohet Hera e parë i njëjti është dërguar në komision disiplinor me 3 qershor në kohë pandemie kur qeveria mori vendim që aktivitetet mos të ketë deri me 15 qershor. Dhe komisioni ka hedh poshtë pretendimet e ngritura nga qeveria komunale. Tani është hera e dyte me 14 shtator isha në komunë për një dokument të djalit pse nuk je në zyre. Vizita e aktorit James Fetahu për film dhe ndihmës për teatrin me disa reflektorë ai donte ta shihte sallën e filmit dhe në pimë kafe ky është shkaku kinse i tyre. Andaj po kërkoj nga kjo qeveri që në vend të shantazheve të të punësuarve të merren me obligime ditore.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimet e tij lidhur me procesin mësimor në kohë të pandemisë. Tutje ai i sugjeroi qeverisë komunale që të ndaj mjete financiare nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për Drejtorinë e Arsimit, për furnizim me maska dhe dezinfektues për duar, për dezinfektim të objekteve shkollore. Ai përmendi se disa shkolla vërtet nuk janë në gjendje të mirë siç është ajo e fshatit Smrekonicë, e cila ka mungesë të ujit kohë pas kohe, pastaj edhe vet objekti i shkollës nuk është në gjendje të mirë, pasi ka myk në plafonin e shkollës. Ai pyeti se deri ku ka shkuar projekti për renovimin e kësaj shkolle, dhe përsërit se duhet të ndihmohet DKA-ja me mjete financiare për tu investimet nëpër shkolla.

Afrim Namani, drejtor i DKA-së-paraqiti sqarime hyrëse të përgjithshme duke u përgjigjur në çështje e ngritura nga parafolësi i tij.

Besim Muzaqi, nënkryetari i komunës-propozoi që pika njëmbëdhjetë të draft-statuti të Teatrit të Qytetit ti hiqet arsyetimi dhe i njëjti ti nënshtrohet diskutimit publik për plotësim-ndryshim. Kjo duhet të bëhet ashtu që të jepen propozime të ndryshme dhe në mbledhjen e radhës të vjen në lexim të dytë për aprovim final.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi që draft-buxheti për vitin 2021 të mos procedohet në rendin e ditës të kësaj mbledhje, për faktin se anëtarëve të kuvendit iu është dërguar me vonesë materiali dhe si i tillë kjo materie kaq me rëndësi nuk është shqyrtuar mirë nga ana e anëtarëve të kuvendit. Mendimi i tij është që për këtë pikë të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme që do të trajtohet propozim-buxheti për vitin 2021 si pikë e vetme e rendit të ditës. Ndërsa vlerësoi se ky projekt –buxhet është më jo profesional dhe më i dobët për gjatë gjithë këtyre viteve të pasluftës.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se është kërkesë ligjore që buxheti të aprovohet gjatë kësaj mbledhje për shkak të afateve të përcaktuara ligjore, dhe i njëjti mund të analizohet dhe diskutohet gjatë tërë ditës së sotme. Në të kundërtën ai vlerësoi që ky buxhet është i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në mënyrë tejet profesionale dhe për kah metodologjia është i njëjtë me projekt buxhetet e viteve të kaluara. Tutje shtoi se ky buxhet është tejet i rëndë të cilën nuk do të donte ta prezantonte para kuvendit sepse është buxhet-covid me shkurtime radikale të mjeteve financiare. Pastaj ceku se rimëkëmbja ekonomike do të jetë e mundimshme dhe do të marrë kohë pasi që pandemia ka lënë gjurmë të rënda në ekonomi por edhe në aspektet tjera. Në buxhetin e planifikuar për vitin 2021 kemi 1,000.000 € më pak për shkak të shkurtimeve, por rreziku potencial është që edhe ky buxhet mos të mbushët nëse vazhdon pandemia. Ai ftoj të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në kuvend që ta përkrahin projekt-buxhetin për futje në rend dite. Vlerësimet e tij janë se nuk është buxheti më i mirë i mundshëm, por që shpreson që pas aprovimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike të ndahen fonde shtesë për komunat e Kosovës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se si opozitë nuk do të dalin jashtë konstruktivitetit, por se është obligim i tyre që ti japin drejtimin e duhur zhvillimit të qytetit dhe shpenzimit të parasë publike. Andaj duhet bërë përpjekje që buxheti të orientohet në shtyllat e duhura a e jo në linjat e dyshimta, ku do të mund të manifestohen keqpërdorime buxhetore. Andaj ai kërkoi nga të gjitha grupet kuvendare dhe kryetari i komunës që për buxhetin të mbahet një mbledhje e veçantë e kuvendit ku do të bëhej analizimi dhe shqyrtimi i mirëfilltë i buxheti për vitin 2021. Kjo për faktin se materiali për draft-buxhetin ka ardhur vetë një ditë më herët dhe si ai tillë ai nuk ka mund të përpunohet nga anëtarët e kuvendit. Pastaj kërkesat e qytetarëve 500 sosh për futje në buxhet, ata nuk i kanë parë dhe nuk i kanë vlerësuar, edhe pse ato janë adresuar tek kuvendi sepse kuvendi është ai që vendos për aprovimin e buxhetit. Tutje vlerësoi se nëse aprovohet ky projekt-buxheti i cili ka shumë defektet i cili në vetë veten e tij manifeston kontradikta të rrezikshme në shpenzimin e parasë publike, në adresimin e fondeve publike në linja apo shtylla të dyshimta. Në fund ai përsërit që të ulen të gjitha grupet politike dhe të merren vesh për një datë tjetër për aprovimin e

buxhetit dhe të ketë një dakordim për orientimin e buxhetit pasi drafti aktual ka shumë defekte dhe karakterizohet me dyshime sa i përket shpërndarjes së tij.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se pajtohet me parafolësin e tij, se projekt buxheti për vitin 2021 është dërguar tepër vonë dhe si i tillë ai nuk ka mundur të trajtohet si duhet nga ana e anëtarëve të kuvendit. Tutje shtoi se avazi i vjetër për dërgimin e pikave të rendit të ditës në momentet e fundi po vazhdon dhe kjo dëfton se kjo qeveri e komunës është duke i trajtuar sikur “dele” anëtarët e kuvendit. Ai vlerëson se për buxhetin duhet të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme ku do të trajtohet edhe plani i veprimit për rekomandimet e auditorit sepse siç është evidentuar ka shumë shkelje të konstatuara nga ana e auditorit. Pajtohet me kryetarin e komunës se ky buxhet është sikurse i viteve të kaluara pasi që ky nuk ka ide se si bëhet planifikimi i buxhetit, sepse këtë e kemi parë edhe gjatë këtyre dy tri viteve të fundit, ku qyteti është degraduar, betonizuar, duke ndërtuar pa kushte ndërtimi dhe kësisoj është përmbysur e katandisur deri në fund organizimi i qytetit të Vushtrrisë. Andaj konsideron dhe kërkon që dy pikat që kanë të bëjnë me buxhetin dhe planin e veprimit të rekomandimeve të auditorit të largohen nga rendi i ditës, ashtu që këto të shqyrtohen në një mbledhje të veçantë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-duke folur për procedurat e propozimit dhe aprovimin e rendit të ditës, shtroj dilemën që nuk e di nëse nënkryetari i komunës ka të drejtë të propozoi pikë për futej në rend të ditës. Këtë të drejtë e kanë anëtarët e kuvendit por jo edhe nënkryetari, për këtë kërkoj mendimin e zyrës ligjore.

Besim Muzaqi, nënkryetari i komunës-sqaroi se ideja e tij ishte ndryshimi i pikës sa i përket draft-statutit të teatrit të qytetit të Vushtrrisë duke u hequr pjesa e arsytimit, por nuk propozoi ndonjë pikë të re për futej në rendin e ditës. Sido që të jetë shpreh mirënjohje për këshillën e dhënë nga anëtari i kuvendit z.Nezir Klinaku.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-duke mos dashur të kontestohet ligjshmëria e procedimit të pikës së rendit të ditës Draft-statuti i teatrit të qytetit të Vushtrrisë, propozon që këtij dokumenti ti hiqet pjesa e arsytimit dhe si i tillë ky dokument të dërgohet në diskutim publik.

Abit Abiti, ZKF-paraqiti sqarime hyrës lidhur me propozim-vendimin për ndryshimin e vendimit për transferimin e mjeteve financiare, duke shtuar se si rezultat i rritjes së shumës së mjeteve për pagat jubilarë në fushën e shëndetësisë ka ardhur deri tek nevoja e ndryshimit të këtij vendimi.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 20 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 30 korrik 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 10 shtator 2020;
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021 (**shqyrtimi i dytë**);
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të pjesëmarrjes qytetare – Udhëzues i përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal (**shqyrtimi i parë**);
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ecurinë e Hartës zonale komunale dhe zonës historike;
6. Shqyrtimi i Informatës për procesin e korrje-shirjeve;
7. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit me numër 01Nr.47/20 i datës 27.02.2020;
9. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2020;
10. Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021;
11. Shqyrtimi i propozim–vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të teatrit të qytetit Vushtrrisë me nr. 228/14 i datës 30.10.2014;
12. Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e auditorit të përgjithshëm;
13. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për themelimin të komisionit për ankesa;
14. Shqyrtimi i Propozim–vendimeve për anëtarësim në komitete konsultative;
15. Shqyrtimi i propozim–vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01- Nr.150/20 të datës 10.09.2020 për Rialokimin/Transferin e Mjeteve Financiare;
16. të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 30 korrik 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 30 korrik 2020.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 10 shtator 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit 22 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit, e datës 10 shtator 2020.

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021 (shqyrtimi i dytë);

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim vendosi më sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Draft–Planit të pjesëmarrjes qytetare – Udhëzues i përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal (shqyrtimi i parë);

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi pas votimit me 21 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim vendosi më sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani për Pjesëmarrjen qytetare-Udhëzuesi i Përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal
2. Diskutimi publik fillon nga data 25 shtator 2020 dhe zgjat deri më 26 tetor 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet komisioni hartues që si hartues i draft-planit në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të planit në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin tetor 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ecurinë e Hartës zonale komunale dhe zonës historike;
6. Shqyrtimi i Informatës për procesin e korrje-shirjeve;
7. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-tha se kjo informatë është mjaft e detajuar, mirëpo në faqen 2 sqarohet se si është mbetur pa bursë një student ku ndër të tjera thuhet: *Dy kandidatët Sead Pantina dhe Avdyl Rashica kishin numër të njëjtë të pikëve, notë mesatare të njëjtë si dhe datën e aplikimit të njëjtë, mirëpo në bazë të listës së aplikantëve për bursë kemi parë që Sead Pantina ka aplikuar në orë më të hershme sesa Avdyl Rashica dhe bursën ja kemi nda kandidatit që ka aplikuar më herët, kurse kandidati tjetër nuk e plotëson kriterin me notë mesatare mbi 8.00.* Në këtë rast ajo vlerëson se këtij studenti i është shkëlur e drejta për marrjen e bursës. Një dallim i tillë apo një kriter siç është koha e aplikimit mund të jetë një thyerje apo një zhgënje dhe demotivim në studime për kandidatin në fjalë, apo edhe pamundësim i vazhimit të studimeve. Andaj kërkoi nga DKA-ja që të jap sqarime dhe pasi që buxhet ka ti jepet bursa edhe këtij studenti. **Afrim Namani, drejtor i DKA-së**-paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke shtuar se rregullorja aktuale për bursat përcakton se kandidatët për bursë përfitojnë bursë konform kriterëve siç është nota mesatare e në rast se kemi kandidatë me notë mesatare të njëjtë pas presjes dhjetore atëherë merret si kriter koha se cili kandidat ka aplikuar më herët për marrjen e bursës. Pastaj ai sqaroi se nga shpallja e më hershme kanë tepruar mjete financiare dhe janë duke shikuar modalitetet ligjore që të ketë sërish shpallje të konkursit konform mjeteve të mbetura financiare.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit me vota “unanime” në kuadër të informatës për bursa, dhe sqarimeve tjera ligjore vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim autorizohet kryetari i komunës që të zhvilloj procedurat ligjore, lidhur me shpalljen e konkursit për bursa për studentë, konform mjeteve financiare të mbetura nga konkursi paraprak.

2. Konkursi duhet të shpallet për vitin akademik 2019/2020.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesët: kryetari i komunës, Drejtoria për Arsim si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit me numër 01Nr.47/20 i datës 27.02.2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi më sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 4 e vendimit 01nr. 47/20 datë 27.02.2020 për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur, dhe riformulohet si në tekstin në vijim: “Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të zbatohet nga data 01.01.2020”.

2. Për zbatimin e këtij vendimit obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

9. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2020;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, aprovoi raportin për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2020.

10. Shqyrtimi i draft - buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021;

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-në ekspozueun e tij para kuvendit, lidhur me draft-buxhetin dhe planet investuese për vitin 2021 deklaroi se: buxheti i komunës për vitin 2021 është para jush i cili ka epitelin e buxhetit-covid, i ndikuar radikalisht nga efekti i pandemisë globale të quajtur si covid -19 i njohur si corona-virus. Më tej shton se citojmë: do të doja që sot bashkërisht <ti themi jo këtij buxheti>, kjo për faktin se për herë të parë pas shumë viteve që nga pas lufta kemi shkurtime buxhetore, e që praktika ka qenë që çdo vit praktika ka qenë që kemi pasur rritej të

vlerave të mjeteve sa i përket projekteve kapitale. Më gjithë këtë ne nuk mund ti themi jo këtij buxheti për shkak se të gjithë jemi koshient për ndikimin e madh ekonomik dhe krizën globale që e ka shkaktuar pandemia covid-19, prandaj ai i fton të gjithë anëtarët e kuvendit pa dallim që ta përkrahin me votë projekt –buxhetin e komunës për vitin 2021. Për kund ndikimit të madh të pandemisë është përcaktuara që projektet me peshë vitale për qytetin të mos preken siç janë: projekti i ujësjellësit nuk do të preket nuk afektohet do të kompletohet si projekt gjatë vitit të ardhshëm. Përkundër ndikimit të madh gjithashtu nuk ka pasur zvogëlim të konsiderueshëm të buxhetit në fushën e shëndetësisë dhe arsimit. Në kategorinë e subvencioneve do të kemi mbi 600.00.00 € ku mundësia do të jetë më e madhe të mbështesim sportistët, kulturën, rinin, ti mbështesim OJQ-të rinore si dhe do të kemi mundësi ti zbatojmë politikat sociale për të cilat jemi zotuar dhe kemi premtuar më herët, si p.sh pagesa e shumës prej 120 € për fëmijët e lindur në Komunën e Vushtrrisë. Rritja e subvencioneve për Komunën e Vushtrrisë ka ardhur si rezultat i punës së bërë në bashkëpunim me USAID-in, Zyrën e Auditorit dhe Ministrinë e Financave. Kjo është një punën e mirë pasi që vitet me radhë komuna ka aprovuar mjetet në cilësi subvencione për projekte në Drejtorinë e Bujqësisë nga kategoria e investimeve kapitale e që realisht ato janë subvencione dhe në këtë rast auditori i përgjithshëm i ka vlerësuar këto si keqklasifikim sepse këto duhet ti ishin planifikuar si subvencione. Ai vlerëson se tani do ta kemi më lehtë pasi që shumë politika komunale siç është mbulimi i shpenzimeve të varrimit do të mbulohej nga kategoria e subvencioneve dhe auditori nuk do të gjejë keqklasifikim të parasë publike, pasi që subvencionet janë rritur. Buxheti në bujqësi nuk do të afektohet ku është parashikuar një buxhet prej 220,000.00€ me bashkëfinancim me donator dhe qëllimi është që kjo shumë të trefishohet bashkë me ndihmat që vinë nga donatorët në bujqësi siç ka ndodhur në këtë vit ku kemi pasur bashkëfinancim me Islamic Relief, dhe IADK-në dhe realisht investimi në bujqësi ka qenë më i madh se sa që kemi planifikuar në buxhet. Ai beson se me aprovimin e ligjit për rimëkëmbje ekonomike Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndaj fonde për komunat e në këtë rast edhe për Komunën e Vushtrrisë në mënyrë proporcionale me numrin e banorëve, dhe duke marrë për bazë efektin goditës të pandemisë në ekonomi. Në këtë vit nga fondi për rimëkëmbje ekonomike komunës sonë i janë ndarë 250,000.00 €. Këto mjetet financiare do ti propozohen kuvendit ashtu që të aprovohen si subvencion dhe me këtë do të financohen normat e interesit për bizneset dhe me këtë do të mund të lirohen fonde nga 2 deri në 3 milion euro fonde nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Projekt tjetër i inkorporuar në këtë buxhet është pastrimi i lumenjve në fshatin Samadrexh dhe Dumnicë e Epërme. Në bashkëpunim me Komunën e Obiliqit do të bëhet pastrimi i lumit që vjen nga Kozarica e që derdhet në lumin Silnica. Në saj të kërkesave që kanë dal nga diskutimet publike kanë dominuar kërkesat për kanalizim dhe nga 90,000.00 € që kemi pasur në vitin 2020 kemi vendosur 190, 000.00 € në vitin 2021, për ndriçim publik kanë dominuar kërkesat andaj buxheti është rritur nga 15,000.00 € në 50.000.00 € por ky fond nuk do të jetë i mjaftueshëm për mbulimin e kërkesave për ndriçim publik. Gjithashtu kemi investimin nga Qeveria e Kosovës për zgjerimin e rrugës në hyrje të qytetit e cila po transformon qytetin, po ashtu kemi premtimin e qeverisë qendrore për financimin e projektit për unazën në pjesën perëndimore të qytetit ku kjo do të ndikonte në balancimin e zhvillimit të qytetit me pjesën tjetër. Pastaj kemi kërkesë për ndërtimin e rrugës Sllakoc-Kurillov-Vesekoc, ky është futur si kod buxhetor, sepse kemi premtimin e qeverisë që do ta financoj këtë projekt. Kërkesë tjetër është ndërtimi i rrugës që lidhë fshatin Smadrexhë me fshatin Dumnicë e Epërme, ku do të lehtësohej punimi i tokave bujqësore, edhe ky projekt është futur në buxhet ashtu që të mundësohet financimi nga Ministria e Infrastrukturës. Në kuadër të buxhetit për vitin 2021 nuk janë prekur mjetet sa i përket ndërtimit të rrugëve, dhe janë në procedurë të lidhjes së një kontrate tre vjeçare për përfundimin e të gjitha rrugëve që kanë dal

si kërkesa nga diskutimi publik. Në fund të diskutimit të tij ai përsërit se buxheti për vitin 2021 është buxhet i corona-virusit, që nuk do të donte kurrë të propozonte për aprovim, por megjithatë ai ftoj të gjitha grupet politike të përfaqësuara në kuvend që ta aprovojnë këtë projekt-buxhet sepse është obligim ligjor dhe qytetarë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se kërkesat e qytetarëve nga dëgjimet buxhetore nuk janë përfshirë në projekt-buxhet, andaj propozoi që të asfaltohet Rr. Ismajl Zekolli 360 m me gjerësi 4 m 20.000,00€, nga kategoria asfaltimi i rrugëve në fshatra, Dumnicë e Epëme Rruga nga shkolla e vjetër Shaban Musliu dhe Hashim Imeri zgjerim i rrugës për një metër 1200 m 25.000 € nga kategoria asfaltimi i rrugëve në fshatra. Lidhur me draft-buxhetin ai vlerësoi se propozim-vendimi për aprovimin e buxhetit komunal 2021 i propozuar është buxhet me defekte dhe manifeston në vete kontradikta të rrezikshme për shpenzimin e parasë së qytetarëve. Në këto ndarje buxhetore si kurrë më parë në historinë qeverisëse të Vushtrris na paraqiten pozicione me vlera të majme dhe me destinim të dyshimtë të shpenzimit të parasë së qytetarëve për aprovim madje edhe në projekte inventive të cilat projekte janë të në kontinuitet. Me paraqitjen e ndarjeve buxhetore qeveria tallet me asamblistët dhe me qytetaret p.sh imagjeroni kjo qeveri e dështuar propozon buxhet në vlerë vetëm prej 15.000 € për ndërtimin e tregut të gjelbër të qytetit madje për ndërtimin e stacionit të autobusëve propozon ndarje buxhetore në vlerë prej 50.000,00€ kjo është fyerja e tret që i bëhet kuvendit dhe qytetarëve. Por ndryshe është te pozicionet ku mund të manipulohen mjetet financiare e të përfitohet në mënyrën e kundërligjshëm këtu qeveria komunale nuk tallet por propozon si ilustrim po ju japi shembullin Tek kodi 470 Bujqësia kjo qeveri propozon për tri pozicione me Nr. të nën/projektit 47024 dhe atë; 1.Rregullimi i kanaleve kulluese, 2.Pastrimi i lumenjve dhe 3.Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave vlerën në total prej 194.000,00€ kurse në të njëjtën kategori vetëm në një pozicion me Nr. të nën/projektit 90231 Projektet në bashkëfinancim me donator propozon vlerën totale prej 270.000,00€. Shtrohet pyetja pse? Përgjigja është e thjeshtë këtu ka hapësirë manipulimi, keqpërdorimi dhe përfitimi e para dhe e dyta kjo qeveri nuk e ka idenë se parandalimi gjegjësisht preventiva me investimin e parasë së qytetarëve për qëllime të mbrojtjes dhe krijimit të kushteve të sigurta për jetën e qytetarëve dhe pronën e tyre është e rëndësishme së veçantë. Paramendojeni tek infrastruktura propozon ndarje buxhetore në stilin sa më larg syve aq më larg zemrës po ilustruj dhe pyes: Çfarë logjike ka propozimi për ndarje buxhetore Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra në vlerën më se 1 milion € kurse në qytetin e Vushtrris vetëm 45 mijë €. Me një fjalë neve sot na paraqitet një propozim vendim për aprovimin e buxhetit komunal për vitin 2021 të cilin nuk do kisha pas dëshirë ta shihja si të tillë sepse është një fatkeqësi që nuk do mundemi ta pranojmë. Nuk ka të planifikuar mjete financiare për ndihma familjeve skamnore sidomos edhe atyre të prekurave nga Covid-19 e as bizneseve andaj si i tillë nuk është buxhet as premtues e as zhvillimor dhe nuk përmbush pritjet e qytetarëve. Në fund ai tha se grupi kuvendar i PDK-së nuk do ta përkrah një buxhet të tillë me kaq shumë defekte dhe votimi i tij do të jetë në ndërgjegjen e secilit anëtarë të kuvendit.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimit të kryetarit të komunës, i cili aq bukur me pasion e dëshirë i projektton gjërat në letër por pa realizim praktik. Ky buxhet është i njëjtë sikur se ai i para tri viteve pa vizon dhe pa ide në planifikim është i mangët dhe këtë e ka mangësi personaliteti i tij. Tutje shtoi se kryetarin e komunës nuk e kemi parë të mbjellë ndonjë pemë në Vushtrri, në hapësirat publike asnjë investim. Pastaj vlerësoi se ky nuk është buxhet i covidit por është buxhet i asfaltit. Në orientimin e projekteve ka diskriminim 27 rrugë në fshatin Stanoc i Poshtëm, për këtë nuk e di se ku do të mbërrin me këtë kryetari por ndoshta dëshiron ti fitoj votat në fshatin Stanoc, por e siguroj se ai e mund në këtë fshatë vetëm me rinin e Partisë Demokratike. Asnjë ide për rinin, salla në të cilën gjendemi është e dedikuar për rinin por se ajo

është e uzurpuar nga pushteti dhe rinia është përjashtuar nga shfrytëzimi i saj. Megjithëse ai propozoi që ky projekt-buxhet të shtyhet për një mbledhje tjetër që të bëhen disa plotësime-ndryshime, ai propozoi që në këtë draft të futen këto propozime: planifikimin në asfaltiminin e rrugëve, shtrimin e trotuareve dhe ndriçimin publik, në lidhje me draft-buxhetin dhe planeve investuese për vitin 2021:

Rr. Sojishta – Maxhunaj;

Rr. Dul Maxhuni – Maxhunaj;

Rr. Sefedin Maxhuni, të shtrohet me trotuar;

Rr. Besëlidhja Kombëtare - Ndriçime Publik dhe Trotuar;

Rr. Fatmir Rashica - Vushtrri të ndriçohet dhe

Rr. Ilaz Kolla - Kollë të asfaltohet.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-propozoi që në draft-buxhet për vitin 2021 të inkorporohet rregullimi i rrugës “Nezir Imeri” në gjatësi prej 210 metra, kjo rrugë në gjysmën e saj është e shtruar me kubza, ndërsa pjesa tjetër është e pa kalueshme ku duhet të instalohet kanalizimi dhe ujësjellësi.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit-propozoi që futen në buxhet asfaltimi i rrugëve “Isalm Mulaku” në fshatin Ceceli në gjatësi prej 200 metra e cila lidhur shkollën me rrugën në drejtim të fshatit Sllakoc, si dhe asfaltimi i dy rrugëve tjera të cilat janë të pa emëruara shkaku i lëshimit nga komisioni me gjatësi me nga 200 metra.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-pasi paraqiti vërejtjet e saj lidhur me afatet e dërgimit të materialit për draft-buxhetin, shtoi se ky buxhet nuk është aspak në pajtim me nevojat dhe kërkesat e kohës të zhvillimi ekonomik lokal. Pastaj shtoi se ky buxhet cilësohet si buxhet i asfaltit pasi që në asfaltimin e rrugëve janë planifikuar të shpenzohen mbi 1,000.000 €. Ajo ceku se shumica për të mos thënë të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë të asfaltuara, ndërsa rrugët e planifikuara janë të rangut terciar dhe kryesisht kalojnë nëpër pronë private. Kjo qeveri e cila e quan vetën qeveri e ndryshimeve ka trashëguar rreth 90% të rrugëve të asfaltuara dhe prapëseprapë në mungesë të vizionit është orientuar tek asfaltimi i rrugëve. Mandej vlerësoi se nuk është harmonizuar buxheti me obligimet kontraktuale që ka komuna me kontratat dy vjeçare të cilat duhet të përmbushen përmes planifikimit buxhetor, shembull kontrata për sinjalizim horizontal dhe vertikal për të cilën komuna është në borxhe rreth 40,000.00 €, ndërsa ka planifikuar vetëm 28,000.00 €. Gjithashtu mendon se do të duhej të planifikohej më shumë buxhet për mirëmbajtjen e infrastrukturës, për shkak se në mungesë të mirëmbajtjes sistematike të infrastrukturës rrugët janë në mos më keq. Tek Drejtoria e Administratës janë planifikuar 10,000.00 € për E-kjosqet të cilat janë donacion të përfituara nga qeveria e kaluar ato që janë ekzistenciale janë jashtë funksionit dhe qytetarëve shpeshherë iu është dashtë që për një dokument të shkojnë në komunat tjera. Një çështje tjetër e cila mungon e që duhet patjetër të planifikohet në buxhet është ndërtimi i infrastrukturës për peronat me nevoja të veçanta, nuk janë paraparë pjerrina për gjatë rrugëve, trotuareve dhe objekteve të institucioneve, nuk janë paraparë shtigje për peronat e verbër dhe për persona me shikim të dobësuar. Andaj propozimi i saj është që qeveria ti ketë parasysh këto vërejtje të bëra dhe ti ndryshoj shumatat e planifikuara në buxhet, ndërsa prej kodit ekonomik asfaltimi i rrugëve të realizohet projekti për ndërtimin e pjerrinave dhe shtigjeve për peronat e verbër. Në fund tha se po të kishte kohë më tepër ta analizoj këtë projekt-buxhet do ti evidentonte edhe vërejtjet tjera gjë për të cilin mendon se ky buxhet është më tepër i deshëm se sa i dobishëm për qytetarët.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se grup kuvendar i LVV-së e përkrahin draft-buxhetin e komunës për vitin 2021 duke ftuar edhe të tjerët që ta bëjnë një gjë të tillë duke mos pasur ndarje

në kohë pandemie. Nga dëgjimet buxhetore të vitin 2019 ka dal si kërkesë ndërtimi i rrugës “Lumni Surdulli” në fshatin Samadrexhë dhe kjo kërkoj që të inkorporohet në buxhet. Pastaj në fshatin Reznik rr. “Shemsi Zeneli” të futet në buxhet për asfaltim. Pastaj ceku se anëtar i kuvendit Lorik Maxhuni nuk kishte marrë pjesë në diskutimin buxhetor në fshatin e tij në Maxhunaj ku kishte dal si kërkesë rregullimi i Rr.”Drita” e cila lidh diku rreth njëmbëdhjetë familje dhe kërkoj që edhe kjo rrugë të jetë pjesë e buxhetit. Ai i sugjeroi kolegut të tij z.Lorik Maxhuni që të merret me problemet dhe interesat e qytetarëve para se merret me numrin e rrugëve në fshatin Stanofc i Epërm, ndërsa sa i përket fitimit të votave në fshatin Stanof ai deklaroi se koha e fitores së PDK-së në këtë fshat ka përfunduar.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-në referim të diskutimit të parafolësit të tij, ceku se nuk është mirë të tentohet të krijohen ndasi, pasi ai dhe PDK-ja kurrë nuk kanë ngritur ndasi mes subjekteve politik e veçanërisht mes anëtarëve të kuvendit. Sa i përket ndërtimit të rrugëve në fshatin Stanoc i Epërm ai nuk është kundër, por duhet të kemi shpërndarje edhe në fshatrat tjera e jo që disa prej tyre të mbesin në lloç ndërsa në një fshat siç është Stanoci të ndërtohen 74 rrugë. Në fshatin Stanoc janë ndërtuar shumë rrugë, madje ka pasur diskriminim në baza partiake sepse disa lagje siç është ajo e “prekazëve” nuk iu është shtruar rruga vetëm pse janë përkrahës të PDK-së. Kjo është shumë e vërtet ndërsa Partia Demokratike e Kosovës, kurrë nuk ka vepruar mbi baza politike për njëzet vite më radhë. Ndërsa të tjerët edhe dëshmorët po i veshin me flamurë politik, duke shtuar se raporti i auditorit nxjerr që LDK ka keqpërdorë në fondet në ndërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” sepse këta vjedhin edhe në “tendera të dëshmorëve”. Andaj LVV nuk është në gjendje të bëj opozitën pasi vetë është e përfshirë në koalicion por edhe e zhytur në keqpërdorim. Tutej shtoj se PDK në Vushtrri është shumë e fortë e cila ka 13,000.00 vota dhe të gjithë janë bërë bashkë për ta mundur. por e vërteta është se ne prapë do të ftojme. Kjo qeveri është qeveri e korrupsionit dhe hajnisë, e cila vetëm ka rrënuar dhe asnjë projekt kapital nuk e ka sjellë për qytetarët e Komunës së Vushtrris.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se për njëzetë vite më radhë qytetarit të Vushtrrisë komuna nuk ka qenë në gjendje ti ofroj shprehur figurativisht një gotë me ujë, dhe është pikërisht kjo qeveri LDK-LVV e cila po e bënë realitet një gjë shumë elementare shpërndarjen e ujësjellësit. Duke replikuar me parafolësin e tij vlerësoi se PDK dikur i ka pasur 13,000.00 vota mirëpo tani gjërat kanë ndryshuar sepse kësaj partie i nevojiten edhe dy mandatet në opozitë që të rikuperohet nga e kaluara e të qenit në pushtet.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-propozoi që të futet në projekt-buxhet, ndërtimit i rrugës “Shaban Bejta” në fshatin Smrekonicë në gjatësi prej 250 metrave.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se sa i përket ujit, ceku se dihet se kush e ka ndërtuar fabrikën e ujit dhe shtrirjen e gypave kryesor të ujësjellësit këtë e ka bërë PDK-ja dhe kryetari Bajram Mulaku. Lidhur me organizimin politik ai shprehu se PDK është tepër e organizuar dhe e mobilizuar dhe votat do të jenë për këtë subjekt, pasi që qytetarët e kanë parë se qeveria aktuale është vetëm duke keqpërdorur paranë publike. Në fund ai mori shembull se sikur Albin Kurti të vdiste atëherë si do ti fitonte votat Lëvizja Vetëvendosje, duke shpërfaqur se krejt votat në Komunën e Vushtrrisë për këtë lëvizje shkojnë për emrin e Albin Kurtit.

Besim Muzaqi, nënkryetari i komunës-pyeti se përmendja e vdekjes për Albin Kurtin a paraqet kërcënim publik.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se përmendja se ne e dimë se kush ku voton është itimidim i votuesve dhe qytetarëve dhe kërkoj që të gjithë të përmbahen nga kjo gjuhë në kuvend, pasi nuk jemi sot në fushatë zgjedhore. Me këtë lloj propagande dhe këtë tentim frikësimi të qytetarëve se

kush kënd e voton është turpshme kjo gjuhe e përdorur në kuvend, kur jemi duke debatuar për buxhetin e komunës si dokumenti më i rëndësishëm i vitit për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. **Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se askush nuk mund të tjetërsoj vullnetin qytetarë të votave të cilat i ka marr PDK-ja në Vushtrri. Ai vazhdoj duke sqaruar se projektet të cilat i ka lënë Partia Demokratike në Vushtrri, duhet që dikush ti vazhdoj, ato janë projekte tonat të cilat janë të faktuar me letër të hartuar me aktivitet e punë të vazhdueshme dhe edhe po të dojë dikush nuk mund ti mohoj. Ai apeloj që të shmangemi nga gjuha e urrejtjes dhe komprometimit të njëri tjetrit e ti kthehemi debatit për projekt-buxhetin e komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se rregullorja e punës së kuvendit, që nga viti 2018 është shkelur gati në çdo seancë dhe reagimi duhet të jetë i njëjtë për secilin subjekt politik. Sa i përket ujësjellësit në mënyrë metaforike shprehi se: <nëse nuk ke gjygyim në gotë nuk do të mundësh të pish ujë>. Lidhur me fshatin Stanoc ao pohoj se gati që tri vitet profesori Haradinaj na fletë vetëm për këtë fshatë.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-sqaroi se buxhetin e komunës e kanë përgatitur personat e njëjtë të cilët kanë punuar që dhjetë vitet edhe në buxhetet e viteve të kaluar. Këtë vit është e vërtetë që ka pasur vonesa pasi që qarkorja e tretë buxhetore ka ardhur tepër vonë një ditë para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit. Ai kërkoi që ky buxhet të aprovohet sot pasi ka tepër punë sepse buxheti është sjellë në formën sintetike, ndërsa puna analitike nuk ka përfunduar akoma pasi çdo projekt duhet të futet në BDMS. Tutje u përgjigj në vërejtjet e anëtarëve të kuvendit të cilët deklarojnë që ky është buxhet i asfaltit, ndërsa kërkesat e tyre në përgjithësi janë për asfalt. Lidhur me kontratën për sinjalizim horizontal dhe vertikal sqaroi se është përgjegjësi e menaxherit të kontratës që të njoftoj Drejtorinë e Buxhetit për mungesë të mjeteve financiare.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-tha se sa i përket kërkesave të shtruara nga anëtarët e kuvendit, njoftoi se nuk ka mundësi të shtohen kodet të reja buxhetore. Mirëpo pavarësisht kësaj në listën e rrugëve janë futur të gjitha kërkesat e parashtruara deri më tani dhe në fund do të inkorporohen edhe të gjitha kërkesat e parashtruar nga anëtarët e kuvendit kur të hartohet lista përfundimtare. Ai sqaroi se lista e aprovuar e shtrimit të rrugëve nga viti 2019 ka pasur vlerën prej 7.2 milion euro, dhe komisionit ka vendosur kritere për përzgjedhjen e ndërtimit të këtyre rrugëve, andaj edhe në këtë vit do të merren rrugë nga ajo listë pasi e njëjta sikurse kjo e këtij viti ka kaluar në kuvend. Sa i përket shesheve sqaroi se kostoja financiare e ndërtimit të sheshit “Hasan Prishtina” ka qenë 176,000.00 € ndërsa sipërfaqja e njëjtë e sheshit “Ahmet Krasniqi” është ndërtuar me një kosto prej 98,000.00 €, d.m.th dihet qartë se çfarë ka ndodhur me këto mjete.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-njoftoi se edhe për kundër deklaramit të grupit kuvendar të PDK-së se do të votoj kundër buxhetit, qeveria komunale është e gatshme që gjitha kërkesat e tyre për projekte ti fus në buxhetin e komunës për vitin 2021, për të treguar se buxheti nuk është i një partie politike por është i qytetarëve dhe do të shkoj tek ta në mënyrë proporcionale. Ai sqaroi se i kanë evidentuar të gjitha kërkesat dhe të gjitha do të inkorporohen në buxhet dhe të njëjtat do të realizohen konform buxhetit që kemi në dispozicion. Pastaj shtoi se në këtë kohë të vështirë të pandemisë nuk e ka ndërmend të filloj ndonjë fushatë parazgjedhore por uron që kjo gjë të përfundoj në mënyrën më të lehtë të mundshme. Tutje shtoi se rrugët “Sojishta” dhe “Sefedin Maxhuni” ndriçohen këtë vit andaj nuk ka nevojë të futen prapë në këtë buxhet, po ashtu rruga “Dul Maxhuni” do të jetë pjesë e buxhetit. Kur është fjala tek dallimi i orientimit të projekteve fshatë-qytet rikujtoj që politikë komunale është që rrugët në qytet sidomos rrugicat të shtrohen me kubëza, kjo për faktin se qyteti është në zhvillim, dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza mundëson instalimin e infrastrukturës nëntokësore dhe kthimin e asaj rruge në gjendjen paraprake, prandaj për këtë nuk është parapa asfaltim në qytet, dhe për dallim nga qeveria e kaluara që ka pasur zero

investime në qytet sa i përket asfaltimit, qeveria aktuale është duke e përfunduar rrugën që shkon nga rrethi tek stadiumi dhe përfundon tek spitali, kjo rrugë është duke u përfunduar me standarde të larta duke u instaluar infrastruktura nëntokësore. Pastaj komuna ka bërë kërkesë në ministri, për riasfaltimin e rrugëve të dëmtuara në qytetin e Vushtrrisë. Në saj të kësaj logjike del se nuk ka dallime sa i përket orientimit të projekteve kapitale në raport fshat-qytet. Lidhur me hapësirat publike, shtoj se është punuar shumë në ndërtimin parqeve në qytet dhe fshatë dhe kjo sikur asnjëherë më parë. Kualiteti i projekteve dallon shumë nga qeveria e kaluar, për këtë kujtojmë faktin se si është punuar sheshi i qytetit ku janë shpenzuar 1,8000.00 € për ndërtimin e tij ndërsa janë mbetur akoma kabllot jashtë të cilat e kanë shëmtuar sheshin, dhe kjo tregon se si janë kryer punët dhe kualiteti i tyre gjatë qeverisjes së kaluar. Mandej shtoi se asnjë objekti kolektiv nuk i jepet leje ndërtimore në qoftë se nuk i ka të planifikuar kushte për qasjen e personave me nevoja të veçanta. Drejtoria e Inspektimeve e ka për detyrë që mos të lejoj asnjë objekt të ndërtohet nëse nuk i zbaton kushtet për personat me nevoja të veçanta. Ai shpreh pajtimin që duhet të kemi më shumë sinjalizim të shtrirë për personat me nevoja të veçanta por që Vushtrria ka një problematikë pasi rrugët i ka të ngusha. Sa i përket tregut për prodhues vendor njoftoi që pa shpenzuar fare para të komunës Drejtoria e Urbanizimit ka hartuar projektin për prodhues vendor, i cili është bërë me paramasë dhe paralogari. Për këtë projekt është dërguar një kërkesë në qeverinë e Katarit për të gjetur një donacion për realizimin e këtij projekti, por që fatkeqësisht këtë projekt e ka penguar pandemia. Në buxhetin e vitit 2021 është vendosur si projekt për faktin se edhe pse është projekt me bashkëfinancim ai duhet të figuroj se projekt në buxhetin e komunës. Ky treg është ideuar të jetë model, ku është analizuar që kostoja financiare e tij do të jetë rreth 500,000.00 €. Për sa i takon stacionit të autobusëve është kryer studimi i fizibilitetit dhe është përcaktuar kostoja financiare e këtij projekti, ndërsa lidhur me caktimin e lokacionit ai sqaroi se ai është kryetari vetëm dhe qeverisja e parë që ka lënë gjurmë që Komunës së Vushtrrisë i ka kthyer pronë dhe atë në sipërfaqe prej 6,5 hektarë tokë, në bashkëpunim me Qeverinë Haradinja të cilën e falënderon. Kjo pronë por shfrytëzohet për të mirën publike siç është ndërtimit i Qendrës së Mjekësisë Familjare tek vendi i quajtur tek thertorja, mandej është kthyer prona përballë Interex-it e cila është regjistruar si pronë e komunës. Për stacionin e autobusëve më herët ka qenë një procedurë për dhënien në shfrytëzim nga Drejtoria e Burgjeve të cilën e ka anuluar me kërkesë të Komunës së Vushtrrisë Kryeministri Hoti ka urdhëruar anulimin e procedurave. Drejtoria e Urbanizimi ka hartuar projektin për ndërtimin e stacionit të autobusëve, pa shpenzuar mjete financiare. Ajo se çfarë ka ndodhur me stacionin e autobusëve në Vushtrri e dinë të gjithë, dhe për këtë ai ka proceduar lëndën në prokurorinë të shtetit për hetim, dhe i bënë thirrje që prokurorisë që ta zbardh këtë rast, pasi nuk ka pasur vendim të kuvendit për rrënimin e objektit të stacionit të autobusëve dhe kjo është bërë në kohën e qeverisë së PDK-së. Ai njoftoi se ka premtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që prona e motel “Vicianumit” të kthehet në pronësi të komunës dhe ditët në vijim presim që kjo të realizohet për të vendosur për lokacion të stacionit të autobusëve, për këtë destinim janë ndarë 200,000.00 € dhe presin që të nënshkruhet një kontratë mbase tre vjeçare për realizimin e këtij projekti. Në fund ai edhe një herë bëri thirrje që në frymën e konstruktivitetit të gjitha grupet politike të përkrahin buxhetin e komunës për vitin 2021, edhe pse përsërit se me këtë buxhet më së tepërmi dëmtohet ai si kryetar komune dhe partia e tij pasi që viti i ardhshme është vit zgjedhor dhe buxheti do të jetë më vogël për 1 milion euro më pak.

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës se ku është caktuar lokacioni për ndërtimin e stacionit të autobusëve, dhe tregu për prodhuesit vendor si dhe data se kur do të fillon realizimi i këtyre projekteve, nëse po ai do ta votoj buxhetin e komunës për vitin 2021. Ndryshe kryetari i komunës mund të fletë vetëm për legalizimet për metër katrorë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-deklaroi se të gjitha propozimet e bëra për rrugë do të futen në listën e rrugëve të hartuar nga Drejtoria e Urbanizimit. Ndërsa sa i përket sinjalizimit për persona me nevoja të veçanta, kuvendi mundet në mbledhjen e ardhshme të bëjë një rezolutë që obligon Drejtorinë e Shërbimeve Publike që fondin për trotuar të vendosë sinjalizimi për persona me nevoja të veçanta.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-propozoi që në kuadër të trotuareve të vendoset një shirit për personat e verbër, kjo do të ishte një lehtësim i madha për këtë kategori të qytetarëve, ndërsa komunës nuk do ti ndikoj në koston financiare të këtyre projekteve.

Refik Maloku, drejtor i DSHP-së-u zotua se në projektet e ardhshme të ndërtimit të trotuareve, do të parashihen edhe shiritat për persona me nevoja të veçanta dhe pjerrinat për persona me nevoja të veçanta.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se lokacioni për ndërtimin e tregut për prodhuesit vendor do të vendoset në pronën që i është kthyer komunës nga ministria që ndodhet në lokalitetin afër interex-it.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2021-2023, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2021 dhe 03/2021 të lëshuara nga MFT-ja.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 është 18,878,129.00 € prej të cilave për:

2.1 Paga dhe mëditje.....	10,691,340.00 €
2.2 Mallra dhe shërbime.....	3,218,600.00 €
2.3 Shpenzime komunale.....	309,035.00 €
2.4 Subvencione.....	600,000.00 €
2.5 Shpenzime kapitale.....	4,059,154.00 €

Gjithsej:.....18,878,129.00 €.

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....1,906,903.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 01/2021 dhe 03/2021 të MFT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2021-2023; tabela 4.2 – investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2021-2023; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2021-2023, si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

11. Shqyrtimi i propozim – vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të teatrit të qytetit Vushtrrisë me nr. 228/14 i datës 30.10.2014;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi pasur një tjetër propozim dhe arsyetim tjetër për këtë akt. Tani kemi diçka tjetër dhe nuk dëgjoj asnjë fjalë nga kryetari i komunës për atë se përse ka ardhur deri tek ndryshimi i këtij statuti. Tani anëtarët e kuvendit janë në dilemë se cila na qenka ajo çështje kaq urgjentet për ndryshimin e emrit të teatrit të qytetit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi se ka një kërkesë nga grupit kuvendar i LVV-së, për ndryshimin e emrit të teatrit, por po ashtu ka edhe çështje tjera që duhet të rregullohen me statutin e Teatrit të Qytetit aktuale ashtu që ky të jetë funksional. Në këtë kontekst sqaroi se ka drejtuar një kërkesë në Ministrinë e Kulturës që trupa e teatrit të jetë e përfshirë në sistemin e pagave të teatrit të qytetit të Vushtrrisë dhe po presim përgjigje nga kjo ministri. Në mënyrë të veçantë kemi një kërkesë nga LVV-ja për emërimin e këtij Teatri me emrin e Adem Mikullovcit, në të kundërtën e kësaj është ushtruar një peticion që ka kundërshtuar këtë propozim por që ky dokument do të shkojë në diskutim publik dhe varësisht nga propozimet do të vendoset prapë në kuvend, ashtu që të kemi uniteti kur votojmë për nderimin e figurave publike të njohura të Qytetit të Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-tha se nuk nderohet një personalitet në këtë mënyrë, duke ardhur një kërkesë e pa qartë në mbledhjen urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa mandej. dy ditë pas të ndërrohet qasja e kësaj kërkesë. Përjetësisht respekt për figurën dhe veprën e të ndjerit Adem Mikullovcit, njëkohësisht shpreh ngushëllime gjithë komunitetit artistik të Komunës së Vushtrrisë dhe më gjerë. Pastaj shtoi se kryetari i komunës nuk e ceku se kush e ka adresuar atë shkresë, por e vërteta është sa janë njerëzit më të rëndësishëm për këtë çështje dhe janë komuniteti artistik. Sa i përket propozimit për ndryshimin e statutit të Teatrit në ç' rast do të propozohet ndërrimi i emrit të këtij teatri nga <Teatri i Qytetit> në <Ademi Mikullovcit>. Në vazhdimi ajo dha disa sqarime lidhur me Teatrin e Qyteti, ku njoftoj se statuti i këtij institucioni është miratuar në vitin 2014 në ç' rast themelohet Teatri i Qytetit, ndërsa ish - kryetari i komunës profesori i nderuar z.Bajram Mulaku formon edhe Këshillin e Teatri ku në krye të këtij komisioni vendoset aktori tashmë i ndjerë z.Adem Mikullovcit për ta nderuar për së gjalli, dhe pikërisht ai këshillë vendos që emërtimi i teatrit të jetë <Teatri i Qytetit të Vushtrrisë>, për faktin se Vushtrria shquhet me emra të njohur të kinematografisë që kanë lënë gjurmë në këtë fushë shoqërore. Andaj emri Teatri i Qytetit është bërë që të jetë emër gjithëpërfshirës, sepse po ta kishim përmendur atëherë një emër edhe sot po ta përmendim një emër <ngrisim dikë mbi të tjerët dhe shkelim të tjerët para dikujt>. Adem Mikullovcit është një figurë e rëndësishme së posaçme jo vetëm në fushën e kinematografisë por ka marrë pjesë edhe në ngjarjet e rëndësishme kombëtare, andaj emri i tij meriton të vendoset në institucione tjera që kanë një rëndësi më të madhe apo vendosja e emrit të tij në ndonjë rrugë të rëndësishme. Në këtë kontekst ajo propozoi që Teatri i Qytetit të Vushtrrisë të ndaj çmimin kryesor në nderim të Adem Mikullovcit. Meqenëse tani ndryshoj formë e punës së këtij statuti bëri të ditur edhe një çështje tjetër që në shkresë është e evidentuar se nëse ndërrohet emri i teatrit duhet të ndërrohet edhe akti themelimi i tij, statuti i tij, xhirollogaria e tij dhe vula dhe gjitha këto e pamundësojnë dhe paralizojnë punën e teatri dhe këto duhet ti kemi parasysh. Në fund ajo kërko që diskutimi i saj të mos politizohet ashtu siç po tentohet të politizohet emri i artistit Ademi Mikullovcit, respekt i përjetshëm jetës dhe veprës së të ndjerit.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-kërkoj që mos të keqinterpretohet dhe të keqpërdoret diskutimi i tij pasi që të ndjerit Adem Mikullovcia ia njeh meritat dhe i jep respektin e duhur të merituar. Por konsideron se ky propozim është bërë nën afekt të Lëvizjes Vetëvendosje për të tentuar të përfitojë kredo politike në radhë të parë dhe e dyta si respekt ndaj familjes Mikullovcia por që ndonjëherë harrojmë se duke tentuar të bëjmë respekt artistëve tanë në fakt iu japim mos respekt. Në tri vitet e qeverisjes të LVV-së arti nuk është promovuar, Drejtoria e Kulturës është më e dështuara në njëzet vite, të flasim për kulturë, së pari ka bindjen se drejtoresha e DKRS-së nuk e di fare se çfarë është teatri, e dyta emërimi i saj në krye të këtij dikasteri është një dështim apriori. Pastaj shih se kryetari aktual z.Xhafer Tahiri e ka njëfarë sensi të artit njëfarë shqisë dhe për këtë beson se nuk do ta kishte vendosur atë drejtoreshë në krye të Dikasterit të Kulturës, por ai ka qenë i shtrënguar nga politika që të bëjë një veprim të tillë. Arti nuk është promovuar në Vushtrri, artistët tonë nuk i respektojmë kur i kemi gjallë, i kemi këtu disa në korridor që po na dëgjojnë nuk i japim respektin nuk ja njohim meritat. Teatrit të qytetit i janë ndarë njëherë 5000 € dhe njëherë 10000 € dhe akoma këto mjetet nuk i janë transferuar teatrit dhe ai tani është jofunksional për arsye të keq-qeverisjes. Pastaj mos të flasim për sportin i cili ka mbrojtje politike, ku kemi ra në ligën e parë si një vend me origjinë shumë të lashtë në futboll kemi pësuar fiasko, ku edhe fondet prej 600,000.00 € janë bllokuar nga Ministria e Kulturës, është uzurpuar stadiumi i qytetit, ku kemi pasur edhe një kërkesë por të gjithë po heshtin por që nuk duhet heshtur sepse sporti është pasqyra jonë dhe duhet të bëhemi bashkë për një qëllim. Në njëzet vjet për herë të parë është mbyllur stadiumi dhe janë larguar gjithë lojtarët me çfarë të drejte dhe me çfarë të krenohemi. Në kontekst të emërimit të teatrit deklaroi se: po të kishte qenë gjallë Adem Mikullovcia nuk do ta kishte pranuar këtë emërim, sepse emri i tij meriton më shumë. Kulturës dhe artit duhet ti jepet haku, e pastaj ejani dhe bisedojmë për emra, sepse ai nuk është kundër por konsideron se Teatri i Vushtrrisë të mbajë emrin e Adem Mikullovcia, nuk i bënë nder as familjes Mikullovcia, as artistit dhe artit në përgjithësi. Ai potencoi se dëshiron të flas hapur sepse në vitin 2014 artisti në fjalë ka qenë kryetar i Këshillit Drejtues të Teatrit dhe nga procesverbalet rezulton se asnjëherë nuk kishte marrë pjesë në takime, ai asnjëherë nuk e kishte dëgjuar të ndjerin të flas për Vushtrrinë, dhe për këtë bëri thirrje të analizojnë bashkërisht figurat të shuara të qytetit dhe artistit në veçanti që e duan e ndjenjë qytetin e Vushtrrisë. Në teatrin e kemi dhe ai është i shqiptarëve por ne si shqiptarë jemi të prirë historikisht të ngarejmë pas emrave, por që në rastin konkret konsideron se artisti në fjalë nuk e ka ndjerë aq Vushtrrinë dhe ai ka pas marrë petkun politik të një force të caktuar politike që ka qenë e drejtë e tij por që konsideron se ai nuk ka qenë i të gjithëve. Andaj konfor asaj që u cekë kërkoi që Lëvizja Vetëvendosje të sjellë një strategji para kuvendit se çfarë të do veprojnë në dy vitet e ardhshme me teatrin e qytetit, si do të promovojë artistët, sa shfaqje do të mbahen si do të subvencionohen, cilët do të jenë artistët pasi kemi shumë të mirë prej tyre por që sillen rrugëve të Prishtinës, nëse kjo bëhet ai do të votojë pro ndryshimit të emrit të teatrit në të kundërtën ai nuk do të votojë për këtë emër të propozuar.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se diçka këtu është keqkuptuar pasi që propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje për emërimin e teatrit është tërhequr dhe ky ka qenë zotim i nënkryetarit të komunës. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është shqyrtuar propozimi por që më vonë ai është ndryshuar dhe tani kemi propozim-statutin për ndryshimin e Statutit të Teatrit të Qytetit i cili do të procedohet në diskutim publik.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-sqaroi se si ka ardhur deri tek kjo gjendje sa i përket propozimit të LVV-së për ndryshimin e statutit të teatrit të Vushtrrisë, por pa dashur të jep konotacion politik diskutimeve të disa anëtarëve të kuvendit, për të cilat i vjen shumë keq, pasi që Adem Mikullovcia ka qenë jo vetëm figurë por personalitet unifikues dhe artisë i popullit i cili ka

thirr gjatë gjithë jetës së tij për bashkim e unifikim dhe për vetëdijesim kombëtar. Por të gjitha këto nuk e kishte ndërmend ti thoshte sepse propozimi i tyre u tërhoq për ti dhënë rast diskutimit publik ashtu që propozim-vendimi për ndryshimin e statutit të teatrit të mos jetë vetëm sa i përket emrit të teatrit por të jetë diskutim i tërësishëm. Por megjithatë ne nuk e fshehim por nuk e patën ndërmend ta përmendin që zgjojnë debat të parakohshëm për këtë çështje. Ai i shpreh ngushëllime më të sinqerta familjes Mikullovcit në emër të Lëvizjes Vetëvendosje dhe në emrin e tij personal, në këtë kontekst ai përsërit se nuk e fshehin faktin se propozimi për emërtimin e teatrit të qytetit me emrin e Adem Mikullovcit është bërë nga LVV-ja konkretisht nga kryesuesja e grupit kuvendar znj. Bahrije Ademi-Murati. Por megjithatë duke dashur që të respektojnë procedurat ligjore të cilat janë të përcaktuara me ligj se si duhet ndryshuar statutin e një organi e në këtë rast Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë. Kërkoj nga të gjitha grupet politike që ta mbështesin propozimin e tyre për ndryshim të gjithë ata që ja duan të mirën artit dhe kulturës së qytetit tonë. Gjatë diskutimit publik do të ketë vend për propozime dhe ndryshime të tjera përveç se të emrit. Deklaroi se qëndrojnë tek propozimi i tyre për riemërtimin e teatrit duke vendosur emrin e Adem Mikullovcit, por do të ketë vende edhe për propozime tjera të cilat do të vinë për aprovim final në mbledhjen e ardhshme të kuvendit, e që do të vendoset me votë, por apeloj që mos të ketë fyerje dhe ngitje zëri ndaj figurave të cilat në fakt meritojnë respekt të madh.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se e përkrah diskutimin e nënkryetarit të komunës, duke cekur se sot nuk është momenti i diskutimit pasi që ky dokument do të procedohet në diskutim publik dhe pas marrjes së propozimeve nga të gjithë edhe nga komuniteti artistik në veçanti do të kthehemi sërish tek ju dhe do ta vendosim bashkë për këtë çështje. Lidhur me politizimin e teatrit sqaroi se asnjë artist nuk e ka larguar nga teatri dhe se drejtori i teatrit z. Zahiti është larguar me vetë dëshirë dhe për çështje të karrierës së tij nga Teatri i Vushtrrisë ti cilit i uron sukses dhe të mira në jetë. Aktualisht kemi nevojë të diskutojmë për teatrin dhe gjendjen e tij, dhe njoftoj se ka bërë kërkesë në Ministrinë e Kulturës por kjo është kërkesë edhe shumë komunave dhe asociacionit për ofrimin e ndihmës financiare për teatrot e komunave të Kosovës. Ai u zotua se po kishte pasur mundësi të gjithë artistet e teatrit do ti shtinte në listën dhe sistemin e pagave por që në këtë aspekt me nivelin qendror është duke diskutuar për të gjetur një zgjidhje. Ai duke ju kthyer kujtesës historike të komunës cekur se në këtë kuvend mandatin e kaluar ka pasur një qëndrim për shuarjen e ansamblit të Vushtrrisë, ai ka kundërshtuar një gjë të tillë dhe ai trup është duke u financuar dhe funksionuar shumë mirë. Në fund ai apeloj tek të gjithë ti shmangemi polemikave dhe debateve shterpe ashtu që të votohet për aprovimin e këtij draft-statuti për procedim në diskutim publik dhe më tej të merren propozimet nga të gjithë por edhe ai i Lëvizjes Vetëvendosje, dhe në fund të kthehemi dhe të aprovojmë këtë statut me votat e kuvendit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota "për" të tjerët nuk morën pjesë në votim u vendos me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë me numër 01Nr.228/14 të datës 30.10.2014.**
- 2. Diskutimi publik fillon nga data 25 shtator 2020 dhe zgjat deri më 26 tetor 2020.**
- 3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për**

Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vushtrrisë që si hartues i statutit në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të statutit në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin tetor 2020.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

12. Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e auditorit të përgjithshëm;

13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin të komisionit për ankesa;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Nurtene Çerkezi-Gyshincen për anëtare të komisionit për ankesa.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit- në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Suzana Sylen për anëtare të komisionit për ankesa.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se duhet fillimisht grupit kuvendar politike ti jepet fjala së pari për të bërë propozime për komisione të ndryshme, në rastin tonë së pari duhet ti jepet fjala grupit kuvendar të PDK-së si grupi më i madh kuvendar.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LVV-së falënderoi panelin intervistues për anëtarësim në komitetet konsultative për punën e mirë që kanë bërë, ku si rezultat i kësaj pune kemi deri tani vetëm një ankesë. Në rastin konkret ai e tërhoqi propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje për anëtar të komisionit për ankesa duke ju dhënë hapësirë të tjerëve.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-propozoi z.Nezir Klinaku për anëtar të komisionit për ankesa.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pasi falënderoi parafolësen e tij për propozimin, vlerësoi se në këtë komision mirë do të ishte të kemi juristë pas kemi të bëjmë me shqyrtim të ankesave. Ai tërhoqet ka kandidati për komisionin në fjalë, dhe shtoj se duhet respektohet rregullorja sa i përket dhënies së propozimeve për anëtarë të komisioneve.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-në cilësi të kryesuesit të komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Komiteteve Konsultative falënderoi të gjitha anëtarët e komisionit për punën e mirë që kanë bërë në përzgjedhjen e kandidatëve për Komitetit Konsultative. Pastaj sqaroi se është parashtruar një ankesë nga ana e një kandidati, por që ai është refuzuar të thirret në intervistë si rezultat mos plotësimit të dokumentacionit për aplikim sipas konkursit. Ndërsa ankesat tjera mund të parashtrohen pas publikimit të rezultateve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-e rikthen propozimin që znj. Nurtene Çerkezi-Gyshincen të jetë anëtare e komisionit për ankesa, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, pasi nuk kemi propozime tjera nga radhët e grupeve tjera kuvendare.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se në çdo rast grupi më i madh kuvendar thirret i pari për të bërë propozime dhe kjo është e drejtë ligjore e cila nuk mund të tjetërsohet dhe as ti falet dikujt, sepse madhësia e grupit kuvendar është vendosur me votat e qytetarëve dhe në këtë rast PDK është grupi më i madh kuvendar në kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 23 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendime themelohet komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesave lidhur me pranimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në përbërje si në vijim:

1.1 Nurten Gjyshinca-Çerkezi, anëtare e kuvendit;

1.2 Suzana Sylja, anëtare e kuvendit;

1.3 Fatmir Feka, zyrtarë i administratës komunale;

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë kompetencën për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të kandidatëve për anëtarë të Komiteteve Konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe pas përfundimit të këtij procesi do ta njoftoj kuvendin.

3. Për zbatimin e këtij vendimit obligohet: komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Sekretaria e Kuvendit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë

14. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për anëtarësim në komitete konsultative:

14.1 Shqyrtimi i Propozim – vendimit për anëtarësim në komitetin konsultative për Arsim Kulturë, Fe, Rini dhe Sport;

Pas leximit të emrave të këtij komiteti Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet anëtarësimi i anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini në këtë përbërje:

1.1. Besnik Morina;

1.2. Ilirjana Osmani;

1.3. Arta Gashi;

1.4. Mustafë Pronaj;

1.5. Shpëtim Morina;

1.6. Jeta Haxhaj;

1.7. Alban Bajrami.

2. Komiteti Konsultativ në përbërjen e cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.

01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do ta zgjedh kryesuesin dhe zv/kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini do të jetë katërvjeçar (4), konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini, Kryesuesi i kuvendit dhe Sekretaria e kuvendit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas kalimit të afatit të ankesës prej tetë (8) ditësh.

14.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anëtarësim në komitetin konsultative për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Pas shqyrtimit të këtij Propozim-vendimi kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet anëtarësimi i anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në këtë përbërje:

- 1.1. Kumrije Zhabari;
- 1.2. Saranda Krasniqi Rashica;
- 1.3. Arbër Arifi;
- 1.4. Hamzë Makiqi;
- 1.5. Kadri Maxhuni;
- 1.6. Saim Berisha;
- 1.7. Visar Kameri.

2. Komiteti Konsultativ në përbërjen e cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do ta zgjedh kryesuesin dhe zv/kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale do të jetë katërvjeçar (4), konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për

Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi i kuvendit dhe Sekretaria e kuvendit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas kalimit të afatit të ankesës prej tetë (8) ditësh.

14.3 Shqyrtimi i Propozim–vendimit për anëtarësim në komitetin konsultative për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;

Pas shqyrtimit të këtij Propozim-vendimi kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet anëtarësimi i anëtarëve në Komitetin Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në këtë përbërje:

- 1.1. Edonë Krasniqi;
- 1.2. Elmedina Rama;
- 1.3. Linda Gashi;
- 1.4. Krenare Tahiri;
- 1.5. Festim Xhaferi;
- 1.6. Vesel Sylja;
- 1.7. Hilmi Vllahija.

2. Komiteti Konsultativ në përbërjen e cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do ta zgjedh kryesuesin dhe zv/kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore do të jetë katërvjeçar (4), konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Kryesuesi i kuvendit dhe Sekretaria e kuvendit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas kalimit të afatit të ankesës prej tetë (8) ditësh.

14.4 Shqyrtimi i Propozim–vendimit për anëtarësim në komitetin konsultative për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit;

Pas shqyrtimit të këtij Propozim-vendimi kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet anëtarësimi i anëtarëve në Komitetin Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit në këtë përbërje:

- 1.1. Naser Maliqi;
- 1.2. Bledian Salihu;
- 1.3. Arbnora Berisha;
- 1.4. Blerim Maxhuni;
- 1.5. Egzona Ibishi;
- 1.6. Egzon Bunjaku;
- 1.7. Fitore Fazliu.

2. Komiteti Konsultativ në përbërjen e cekur si në pikën paraprake do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do ta zgjedh kryesuesin dhe zv/kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit do të jetë katërvjeçar (4), konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit, Kryesuesi i kuvendit dhe Sekretaria e kuvendit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas kalimit të afatit të ankesës prej tetë (8) ditësh.

14.5 Shqyrtimi i Propozim–vendimit për anëtarësim në komitetin konsultative për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike;

Pas shqyrtimit të këtij Propozim-vendimi kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet anëtarësimi i anëtarëve në Komitetin Konsultativ Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike në këtë përbërje:

- 1.1. Ilirjana Pllana;
- 1.2. Donika Uka Lahu;
- 1.3. Hasan Maxhuni;
- 1.4. Valmir Duraku;
- 1.5. Besa Maxhuni;
- 1.6. Sahit Beqiri;
- 1.7. Kumrije Muzaqi Mustafa.

2. Komiteti Konsultativ në përbërjen e cekur si në pikën paraprahe do t'i ushtrojë kompetencat dhe funksionin e tij konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

3. Komiteti Konsultativ në fjalë, në mbledhjen e parë të tij do ta zgjedh kryesuesin dhe zv/kryesuesin, për të udhëhequr mbledhjet e komitetit.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike do të jetë katërvjeçar (4), konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komiteti Konsultativ Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike, Kryesuesi i kuvendit dhe Sekretaria e kuvendit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas kalimit të afatit të ankesës prej tetë (8) ditësh.

15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01- Nr.150/20 të datës 10.09.2020 për Rialokimin/Transferin e Mjeteve Financiare;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

FONDI 10 PAGA DHE MEDITJET

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01-Nr.150/20, ashtu që shumës totale i shtohet shuma prej 10,000.00 € duke u shpërndarë sipas pozicioneve të cekura në formularin e Ministrisë të Financave dhe Transfereve i cili është i bashkëngjitur në shtojcë të vendimit sipas programeve si në vijim:

- 1.1. Zyra e kryetarit, me kod 16024, shuma.....(1,000.00€)
- 1.2. Administrata, me kod të programit 16324, shuma.....(8,000.00€)
- 1.3. Inspeksioni, me kod të programit 16647, shuma.....(2,000.00€)
- 1.4. Prokurimi, me kod të programit 16820, shuma.....(1,000.00€)
- 1.5. Zyra e Kuvendit Komunal, me kod të programit 16924, shuma.....(12,000.00€)
- 1.6. Buxheti, me kod të programit 17524, shuma.....(25,000.00€)
- 1.7. Infrastruktura publike, me kod të programit 18184, shuma.....(6,000.00€)
- 1.8. Menaxhimi i fatkeqësive natyrore, me kod të programit 18468, shuma.....(4,000.00€)
- 1.9. Zyra lokale e komuniteteve, me kod të programit 19620, shuma.....(4,000.00€)
- 1.10. Bujqësia, me kod të programit 47024, shuma.....(12,000.00€)
- 1.11. Shërbimet kadastrale, me kod të programit 65120, shuma.....(11,000.00€)
- 1.12. Planifikimi urbanizmi dhe inspeksioni, me kod të programit 66425, shuma..... (9,000.00€)
- 1.13. Shërbimet kulturore, me kod të programit 85024, shuma.....(20,000.00€)

2. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi transferohen në programin Shërbimi i kujdesit primar shëndetësor, me kod të programit 74450, shuma totale 115,000.00 €.


3. Nga programi Arsimit mesëm, me kod 94890, shuma (50,000.00 €), transferohet në programin Arsimit fillor, me kod 93690, në të njëjtën shumë prej 50,000.00 €

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale si dhe Drejtoria e Arsimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:40.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

